



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Via Egnatia shpk” të datës 04.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Via Egnatia shpk” të datës 04.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Via Egnatia shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 04.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

## **Pretendimet ankimore të parashtruesit:**

**P.1.-** " Nisur nga forma e kërkesës së parashtruar nga vet AK, dhe krahasuar me listën e kontratave të realizuara nga GOE i jonë në tre vitet e shkuara që e gjeni të bashkëngjitur, shihet se arrihet mjaftueshëm vlera e kërkuar projekteve të realizuara në kontrata të ngjashme. AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë lidhur me paqartësitë që shihet se i ka pasur sidomos lidhur me natyrën e kontratave që ne i kemi realizuar dhe paraqitur si Grup i OE, andaj me të drejtë konstatohet se AK ka shkelur nenin 59.4 dhe 72 të LPP-së. Përpos kësaj, me rastin e mos kërimit të sqarimeve nga ne, AK ka shkelur edhe nenin 38 dhe 40 të RRPP 001/2022 si dhe nenin 10.1 të UOP-001/2023".

**P.2.-** " Vlen të thuhet edhe kjo se edhe GOE që kishin çmimin më të ulët se tenderi jonë janë cilësuar si të papërgjegjshëm nga AK. Pas analizimit të tenderëve të tyre vërehet se gjendja në plotësueshmërinë e kërkesave nga dosja e tenderit apo më mirë të themi mangësitë e tyre përpos asaj që ka thënë AK, janë si në vijim: Grupi i OE "Muhamet Muçiqi; HARST Group; SH.P.K.; Valdrini sh.p.k." - Anëtari Eco Clean(Muhamet Muçiqi B.I.) nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhe me kërkesat e kontratave të ngjashme - Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Ligji ne 05/L-132(vetëm dud); - Ka dorëzuar CV për teknikun që nuk përmban informatat e nevojshme dhe të pa-nënshkruar nga personi që i përket. Grupi i OE "AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Rexha"; - Anëtari Multi Business Group SH.P.K. - Raporti I vlerësimit të riskut e ka por mungon licenca e Kompanisë së licencuar për ushtrimin e aktivitetit të punës profesionale nga siguria dhe shëndeti në punë; - Marrëveshjet mungon emërtimi i pajisjeve tek të gjitha (nuk janë të cekura pajisjet); - Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Ligji ne 05/L-132; - Mungon marrëveshja me NTSH Gjyli Komerc; Grupi i OE "N & B SH.P.K.; BM Group SH.P.K."; - Nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhe me kërkesat e kontratave të ngjashme; - Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Ligji ne 05/L-132(vetëm dud); Përpos kësaj edhe vet GOE i shpallur fitues ka mangësi në tenderin e tyre që e bëjnë atë tender të papërgjegjshëm. Ja si duken mangësitë e tilla: Grupi i OE "BEREQETI - ING; AAB CONSTRUCTION SH.P.K."; - Vlerësuesi i riskut ka licencën por mungojnë Certifikatat sipas kërkesës dhe dëshmisë së kërkuar në dosje të tenderit; - Damperat nuk janë të regjistruar sipas Ligjit për Automjete Ligji ne 05/L-132(vetëm dud); - Tek pajisja kamion për bartje nuk është ofruar sipas kërkesës se FDT-së pasi që ka ofruar kamionetë me plato bartëse ndërsa ne librezën e prezantuar nga ana juaj shkruan Kamionetë dypellkabinë me dy dyer); - Punëtorët fizik nuk e plotëson kriterin nr. 9 siç është kërkuar (pdf 5.1), mungojnë kontratat e të gjithë stafit fizik sipas listës, për punëtorët Teknik.(lista e paraqitur mungojnë kontratat)".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

## ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- ☐ Ju si GOE-ik nuk i keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2, për pikën e kërkesës nr.1. **Kërkesa: 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme me vlerë minimale prej 780,000.00 € Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Një liste të kontratave të realizuara duke përdorur Aneksin 6 në DT-së, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën, datën e fillimit, datën e përfundimit të kontratës, përfituesin, si dhe listës të bashkëngjitur referencat ose pranimet teknike për kryerjen e punëve në lëmin e kërkuar apo të ngjashme, për 3 (tre) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e shërbimeve (Kontrata dhe Referencat duhet të korrespondojnë me njëra tjetrën). Ju si GOE-ik: për këtë pikë të kërkesës me ofertën e tuaj keni prezantuar Kontrata dhe referenca (Kontrata dhe Referencat duhet të korrespondojnë me njëra tjetrën), mirëpo kontratat dhe referencat e dorëzuara nuk kanë të bëjnë me natyrën e punës dhe as me ngjashmërinë e punëve, Kontratat e dorëzuara kanë të bëjnë me natyrën e pastrimit të lumenjve, mirëmbajtjen rrugëve. Sipas UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK / Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar / Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm/ Neni 69 i LPP-së**  
*Andaj dhe për arsyeje të cekura më lartë jeni eliminuar nga ky Aktivitet i Prokurimit.*

Lidhur me pretendimet ankimore (p.1.) të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi parimisht nuk i konteston fare arsyet për të cilat është eliminuar oferta e tij si e papërgjegjshme por vetëm thekson që është dashur AK të kërkoj sqarime shtesë. Në rastin konkret nuk ka aspak hapësirë për të kërkuar sqarime shtesë AK në kuptim të nenit 72 të LPP për arsye se kontestuese është natyra e kontratave që është prezantuar nga OE në listën e kontratave. Pra me asnjë sqarim shtesë nuk mund të ndryshohet (dhe as nuk lejohet që të ndryshohet) natyra e kontratave si të tilla. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore (p.2.) lidhur me tenderuesit e tjerë është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 07.07.2025



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.